



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Nr. 10462-5187 /22
Kaçanik;

Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut, në bazë të nenit 13, 58 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 9 të rregullorës MF – 02/13 – Për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare për Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË CILAT JANË TË PA PËRDORSHME DHE TË PAVLEFSHME NË DEPO

1. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve edhe atë:
 - Bejtullah Dalloshi
 - Besnik Dema
 - Shefket Kuka
2. Anëtarëte komisionit duhet të asgjësojnë sendet të cilat janë të pa përdorshme dhe të pa vlefshme dhe që nuk i nënshtrohen ndonjë afati për ruajtje.
3. Në punën e tyre anëtarët e komisionit sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të aplikojnë të gjitha procedurat standarte, ashtu siq kërkohen me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë proces dhe në fund të përpilojnë raport, një raport t'i dërgohet edhe zyrtarit të pasurisë për ç'regjistrim të aseteve të cilat janë asgjësuar.
4. Antarët e komisionit duhet ta përfundojnë punën e tyre më së largu deri më 28.02.2022.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e komisionit,
2. Arkivi
3. Zyrtari për pranim të mallërave

Kaçanik më datë 23..02.2022.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

KRYETARI I KOMUNËS

01.104/02-3558/22

Kaçanik.07.02.2022

Në bazë të nenit 13 të Ligjit të vetëqeverisjes lokale, Rregulloren (QKR) Nr.22/2020 datë 21.09.2020 për riintegrimin e Personave të Riatdhesuar neni 44 pika 1,2,3,4 I kësaj Rregullore, Strategjisë Komunale për riintegrimin e personave të riatdhesuar Kryetari i Komunës merr Këtë :

V E N D I M

I

Themelohet Komisioni Komunal për Riintegrim me këtë përbërje:

Xhelel Gashi Drejtor i QPS-së, Kryesues i Komisionit; Fadil Guri (ZKKK); Gafurr Guri (DAK); Eljesa Begunca (DSHP); Hidajete Hoxha (Zyrtare e integrimi Evroplane); Vedat Dema (Zyrtar për të drejtat e njeriut); Arditi Shehu Urbanizëm; Zekir Selimi kataster dhe Qamil Luma (QPS)

II

Komisioni komunal për riintegrim merr vendime për kërkesat e personave të riatdhesuar për përfitime emergjente si dhe masat për mbështetjen e riintegrit të qëndrueshëm sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje

III

Komisioni Komunal për riintegrim duhet të jetë efektiv dhe efikas gjatë ushtrimit të kompetencave për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe të vendos brenda kohës sa më të shkurtë të mundshme por jo më gjatë se 7 ditë nga data e pranimit të kërkesës për skemat emergjente , kurse për skemat tjera vendimet mirren brenda 15 dite nga dita e pranimit të kërkesës.

IV

Me këtë vendim njoftohen Zyra e Kryetarit, antarët e komisionit dhe Zyra Komunale për kthim dhe komunitete



Kryetar i Komunës Kaçanik
Besim Ilazi